



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM

Nr. 19, Datë 03.11.2020

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË QENDRËS “LINJA E KËSHILLIMIT PËR GRA DHE VAJZA”, SHOQATA “RRJETI I FUQIZIMIT TË GRUAS NË SHQIPËRI” DHE QENDRA “ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM”, PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE MBËSHTETËSE PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË AUTORËVE TË KRIMEVE SEKSUALE”.**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në paragrafit 2 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënese të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 33, 42, 47, 87 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutimet e përfaqësuesit të komitetit të nismës ligjvënese;

V Ë R E N

Znj. Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, znj. Ines Leskaj përfaqësuese e Shoqatës “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe znj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e “Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim” kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 13, datë 30.06.2020 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas kërkesës së Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

Vendimi i sipërcituar, ka përcaktuar afatin 4 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për mbledhjen e nënshkrimeve. Afati përfundimtar për depozitimin e fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve për t’u depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga përfaqësia/ komiteti përfaqësues i nismës, është data 30.10.2020.



Nr. 19 i vendimit

Data 03.11.2020 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.

Në datën 29.10.2020 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse.

Në datën 03.11.2020, në mbështetje neneve 33, 42, 47, 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, përfaqësuesit e komitetit përfaqësues të nismës znj. Iris Luarasi, znj. Ines Leskaj dhe znj. Mirela Arqimandriti, për të dhënë mendime dhe shpjegime për kërkesën në seancën dëgjimore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 03.11.2020, ora 12:00 zhvilloi seancën dëgjimore, ku përfaqësuesit e komitetit përfaqësues u përfaqësuan nga zj. Erina Leka me autorizimin e datës 13.11.2020 e cila parashtroi se:

- 1- Komiteti përfaqësues e ka patur të pamundur mbledhjen e nënshkrimeve për shkak situatës së pandemisë virusit Covid-19.
- 2- Referuar urdhërave dhe masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë në kuadër të masave për mospërhapjen e virusit Covid-19, e kemi patur të pamundur që të zhvillojmë takime publike për t’iu shpjeguar zgjedhësve arsyen e mbledhjes së nënshkrimeve.

Duke vlerësuar se situata e pandemisë vazhdon të jetë ende kështu, kërkojmë shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”, deri në 15 dhjetor 2020.

Sa më sipër, ligji nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” nuk parashikon afat konkret për mbledhjen e nënshkrimeve në vende publike apo private si edhe të nënshkrimeve elektronike. Në këto kushte, afati 4 (katër) mujor i përcaktuar me vendimin nr. 13 datë 30.06.2020 për mbledhjen e nënshkrimeve në vende publike apo private si edhe të nënshkrimeve elektronike, është përcaktuar nga organi që ka shqyrtuar kërkesën në kohë, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të paragrafi 2 të nenit 53 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Paragrafi 3 i nenit 53 “Përcaktimi dhe shtyrja e afatit procedural”, të Ligjit nr. 44/2019 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikon shprehimisht se:

*“...afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 53 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe duke marrë në konsideratë se kërkesa është dorëzuar pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve përpara mbarimit të afatit 4 mujor si edhe justifikimet dhe argumentet e parashtruara nga ana e kërkuarit në këtë seancë vlerëson si të ligjshme kërkesën për zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe paragrafit 3 të nenit 53 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

## V E N D O S A:

- 1- Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”, deri në datën 31 Dhjetor 2020.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Ilirjan CELIBASHI**



Nr. 19 i vendimit

Data 03.11.2020 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së Qendrës “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”, Shoqata “Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri” dhe Qendra “Aleanca Gjinore për zhvillim”, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për krijimin e regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale”.